

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“SOLID INVESTMENT GROUP” SHPK

Sot, më datë 10/08/2023, ortakët si më poshtë:

1. **Z. Vangjel Çerepi**, atësia Petraq, lindur më 29.10.1961 në Tiranë, dhe banues në Tiranë, shtetas shqiptar, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal G11029058A.
2. **Z.Arjan Hysenllari**, atësia Fuat, lindur më 13.12.1955, banues në Tirane, në adresën Rr. “Shyqyri Berxolli”, Ndertesa 10, hyrja 1, shtetas shqiptar, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me Pasaportë me numër 032801646, me nr. personal F51213023G.

Vendosën të hartojnë këtë Akt Themelimi, me përmbajtje si më poshtë:

NENI 1
DATA E THEMELIMIT

Sot, më datë 10/08/2023, themeluesit Arjan Hysenllari dhe Vangjel Çerepi vendosën të krijojnë një shoqëri me emërtimin “SOLID INVESTMENT GROUP” SHPK.

NENI 2
FORMA E SHOQËRISË

Kjo shoqëri do të jetë me përgjegjësi të kufizuar (SHPK) derisa të vendoiset ndryshe për shndërrimin në një formë tjeter ligjore të parashikuar nga legjislacioni për shoqëritë tregtare.

NENI 3
EMËRTIMI

Emri i plotë i shoqërisë është “SOLID INVESTMENT GROUP” shpk.

NENI 4
SELIA

Selia e shoqërisë do të jetë në adresen: Rr. “ZEF JUBANI”, Pallati “BJORN”, Shkalla 1, Apartamenti 15, Tiranë.

Me miratim te organeve të saj, shoqëria mund të ndryshojë selinë, mund të hapë degë, filiale, përfaqësi dhe agjenci operative në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë apo jashtë saj.

NENI 5
KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar.

Shoqëria fiton personalitetin juridik në datën e regjistrimit në Qëndrën Kombëtare të Biznesit dhe nga kjo datë ajo mund të fillojë të ushtrojë aktivitetin tregtar deri kur me vendim te Asamblesë së Përgjithshme të vendoset prishja e shoqërisë ose kur shoqëria mbaron në një nga mënyrat e parashikuara në ligjin “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

NENI 6
OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Shoqëria “SOLID INVESTMENT GROUP” shpk do të ketë si objekt të veprimtarisë së saj:

- a) Ndertime, Industriale-civile-turistike dhe sipermarrje per ndertime te konstruksioneve private dhe veprave publike te gjitha kategorive;
- b) Agjensi imobilare dhe komisioneri per te trete;
- c) Studime tregu, Shitje, Blerje, Qiradhenie, Qiramarrje pasurishë të paluajtshme;
- d) Shoqëria mund të ushtroje gjithashtu edhe aktivitete të tjera ndihmese në përputhje me legjisacionin në fuqi të konsideruara me përfitim dhe të dobishme për arritjen e objektivave të saj kryesore.

NENI 7
KAPITALI

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë 10.000 (dhjetë mijë) Lekë, i zotëruar plotësisht nga ortakët si më poshtë:

Emri	Perqindja %	Kuota (pjessë)	Vlera e Pjesmarrjes
Arjan Hysenllari	50 %	1	5,000 (Lek)
Vangjel Çerepi	50 %	1	5,000 (Lek)


Ky kapital është i ndarë në 2 (dy) kuota të zotëruara nga dy ortakët.

Kapitali themeltar do të depozitohet ne një Bankë në Shqipëri, me një llogari të hapur në emër të shoqërisë në formim e sipër.

NENI 8
ADMINISTRATORI

Administratori i parë i shoqërisë “SOLID INVESTMENT GROUP” shpk do të jetë:

Administrator i parë i shoqërisë do të jetë **Z. Vangjel Çerepi**, atësia Petraq, lindur më 29.10.1961 në Tiranë, dhe banues në Tiranë, shtetas shqiptar, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal G11029058A.



Kohëzgjatja e mandatit të tij është 3 vjet me të drejtë ripërtëritje.

NENI 9
DISPOZITAT E FUNDIT

Ky akt themelimi është hartuar në 2 (dy) kopje, në gjuhën shqipe, me fuqi të njëjtë ligjore. Të dhënat tregtare të detyrueshme si dhe të dhënat e tjera për shoqërinë e sapokrijuar, gjenden të detajuara në Statutin e shoqërisë bashkangjitur. Autorizohet Administratori Z. Vangjel Çerepi për të kryer veprimet e regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

THEMELUESIT

VANGJEL ÇEREPI


ARJAN HYSENLLARI
